

**-Mirë se vini në ALPEX-
Operatori I Sistemit të Transmetimit - OST sh.a**

Me kënaqësi njoftojmë Anëtarin e parë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike- ALPEX sh.a, Operatori i Sistemit të Transmetimit - OST sh.a.

OST sh.a me selinë e saj të vendosur në Autostradën Tiranë-Durrës, nënshkroi Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë dhe u bë Anëtar i ALPEX në Tregun e Ditës në Avancë.

OST sh.a është krijuar në vitin 2004 dhe operon rrjetin në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 43/2015 “Mbi Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Kodit të Rrjetit të Transmetimit, Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, Marrëveshjeve dy ose shumë-palëshe dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Në rolin e Operatorit të Sistemit, OST sh.a operon Sistemin Elektroenergjetik duke përdorur teknikat më të mira bashkëkohore mbi operimin e sistemit të transmetimit dhe komponentëve të tij, si dhe duke siguruar balancën ndërmjet gjenerimit, shkëmbimit dhe konsumit të energjisë elektrike.

Kontakt

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX sh.a

Adresa: Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic,
Hyrja 3, Kati 1, Zyra nr.1, Tirana, Albania.
Email: info@alpex.al